



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 19/03/2018 Nr. 020-146
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 1-08 për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete
I miratuar më datë më datë: 24.01.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.01.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim Nr. 1-08 për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete.	Vendimi Nr. 1-08 për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, është në kundërshtim me nenin 61.3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, i cili përcakton qartë se emërimi i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë. Bazuar në komunikimin zyrtar në mes MAPL-së dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit, është vërtetuar se anëtari i Kuvendit të Komunës që ka qenë i pranishëm nga radhët e komunitetit jo shumicë ka votuar kundër.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Xhafer Gashi, gradonačelnik Opštine Obilić Burim Gërguri, predsedavajući Skupštine opštine Obilić	
Kopija	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-su	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština	Datum, 19.03.2018. Br. 020-146
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje odluke Skupštine opštine	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 1-08 za imenovanje podpredsednika opštine za zajednice

Usvojena dana, 24.01.2018. godine

Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 30.01.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da opštinski akt nije u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisanje u aktu opštine	Zakonske odredbe sa kojima je akt opštine u suprotnosti.
1.	Odluka br. 1-08 za imenovanje podpredsednika opštine za zajednice.	Odluka br. 1-08 za imenovanje podrpedsednika za zajednice, u suprotnosti je sa članom 61.3 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, koji jasno određuje da imenovanje podpredsednika za zajednice se predlaže od strane gradonačelnika opštine i treba da se usvaja od većine članova skupštine opštine koji su prisutni kao i većina članova skupštine opštine koji su prisutni, glasaju i pripadaju nevećinskoj zajednici. Na osnovu službenog komuniciranja između MALS-a, i predsedavajućeg Skupštine opštine Obilić, utvrđeno je da član skupštine opštine koji je bio prisutan na sednici iz redova nevećinske zajednice glasao "Protiv".

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od gradonačelnika i Skupštine opštine traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladile za zakonskim odredbama na snazi i u određenom zakonskom roku od 30 dana, od dana primanja zahteva za razmatranje akta opštine. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Qeveria

Nr. -1-08

Data 24.01.2018

Titulli



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/I-040,
(Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe
3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur më dt. 24.01.2018,
mori këtë:

V E N D I M

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Data: 30.01.2018


Nr. i Listës	Nr. i Lejeve	Shënime	Vite
-VI-	020-146		

- I. Emërohet z.Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar i Komunës për Komunitete në Komunën e Obiliqit..
- II. Emërimi bëhet për të njëjtin mandat sikurse edhe mandati i Kryetarit.
- III. Paga i caktohet sipas Udhëzimit Administrativ të Kryeministrit nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në Komuna.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkyetarit
- Kryesuesit
- Drejtorit të ad.së përgj.
- Nënkyetarit për kom.
- DFEZH
- Këshilltarëve
- MAPL
- Arkivit

Kryesues i Kuvendit komunal


Burim Gërguri





Dokumenti:

Nr. L-08

Data 24.06.2018

OBILIQ-OBILIQ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Shkupështina Opëstine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Na osnovu člana 12.2 tačka d) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 (Službeni list broj 28 od 04.06.2008.), Članova 44.1 i 47.3 Statuta opštine i članova 41 i 3.9 Poslovnika o radu Skupštine opštine na sastanku održanom dt. 24.01.2018, doneta je:

ODLUKA

- I. Imenjuje se gđin. Slavica Jakovljević, za Zamenika Gradonačelnika za Zajednice u Opštini Obiliq.
- II. Imenovanje se vrši na isti mandat kao i mandat Gradonačelnika
- III. Plata se određuje prema Administrativnom uputstvu Premijera br.16 / 2008 o plaćanju političkog osoblja u opštini.
- IV. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u protokolu MALS-a i 7 dana nakon objavljivanja na veb sajtu Opštine.

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ			
Shkupështina Opëstine Obiliq			
Registruar në Pushkë të Pushkës Lokale			
Registruar në Ministrinë e Administratës Lokale			
Ministry of Local Government Administration			
Data: 30.01.2018			
Drejtuesi:			
Drejtori:			
Drejtorja:			
-VI- 920-146			

Dostaviti:
-gradonačelniku
-z/gradonačelnika
-presedavajućem
-direktoru Opšte Administracije
-potpredsedniku za zajednice
-DPFRR
-MALS-u
-odbornicima
-arhivi

Presedavajući Skupštine Opštine

Bürim Gerguri



Gafurr Sllamniku

From: Burim Gerguri
Sent: 16. mart 2018 14:28
To: Gafurr Sllamniku
Cc: Shkelqim Jakupi; Xhevat Tafa
Subject: RE: Kërkesë për Përgjigje me shkrim

Përshëndetje Gafurr !

Për këtë edhe më parë ju kam informuar .

Komitetet jo shumicë në Kuvendin Komunal të Obiliqit përfaqësohet nga dy subjekte politike .

Më datë 24 Janar 2018 në mbledhjen e rregullore të Kuvendit Komunal , me propozime të Kryetarit të Komunës është zgjedh Nënkryetari për Komunitet me 12 vota , 7 kundër .

Votimi ka qene i thjeshte me ngritje të dorës sipas rregullorës së kuvendit komunal –Obiliq ,neni 16 ,neni 16.4 ,a) Votimi i thjeshtë .

Kandidati i propozuar për nënkryetar nuk ka pasur të drejte vote , kurse përfaqësuesi tjetër kundër (sipas ekstraktit të procesverbalit) por mundëm qe në seancën e radhës ta pyes se si ka qene vota e tij ?

Mendoj që shumicë nuk di si mundë të ketë kur janë dy , njëri nuk ka drejte .

Unë si Kryesues i Kuvendit falënderojë të gjithë ata këshilltarë komunal që ishin present si ata që votuan pro , si kundër ishte frymë për integrim të komuniteteve . Obiliqi tani ma ka dhënë shembull se si punohet e integrohen të gjitha komunitet .

From: Gafurr Sllamniku
Sent: Thursday, March 15, 2018 12:11 PM
To: Burim Gerguri
Cc: Shkelqim Jakupi; Xhevat Tafa
Subject: Kërkesë për Përgjigje me shkrim

I nderuar, Kryesues shpresojë të jeni mirë me punë dhe shëndet,

Kuvendi i Komunës së Obiliqit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.01.2018 ka miratuar Vendimin Nr. 1-08 për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, ju lutem që të përgjigjeni në mënyrë të shkruar lidhur me këtë pyetje;

- 1) Në momentin e hedhjes në votim të propozim vendimit për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, a është votuar për ose kundër nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.

Ps . Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Neni 61 Nënkryetari i Komunës për Komunitete

61.2 Nënkryetari për Komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si të kryetari.

61.3 Emërimi dhe shkarkimi i Nënkryetarit për Komuniteteve propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë

Ju lutem që të na e ofroni sot përgjigjen brenda ditës !